



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Datë:	12.01. 2018
Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i komunës
Nga	Nazim Gashi , Drejtor i DMSH
Lënda	Raport mujor për dhjetor 2017

Me rënien e temperaturave theksi i aktiviteteve gradualisht bartet nga zjarret fushore e malore në përgatitjen për problemet që shkaktojnë reshjet e shiut e borës, ngricat dhe problemet me vërshimet në disa lokalitete tanimë të njohura për DMSH. Gjithashtu kemi punuar në përgatitjen sezonale të mjeteve teknike dhe pajisjeve që posedon njësia e zjarrfikësve. Si rëndomtë në çdo fund vit edhe gjatë këtij dhjetori është punuar në përmbylljen e aktiviteteve të planifikuara me planin vjetor të punës dhe aktiviteteve tjera të cilat janë imponuar nga terreni. Deri ne mes të muajit në bashkëpunim me DBF janë krye pagesat a faturave të arritura dhe kanë mbetur pa u kryer disa obligime për meremetimin e kamionit intervenues dhe disa furnizime të vogla të cilat marr së bashku nuk kalojnë shumë prej 500 euro.

Pas një angazhimi të përbashkët rreth 15 mujor me donatorin nga Finlanda dhe në bashkëveprim me Zyrën e kryetarit të komunës dhe AME jemi përpjekur me i definuar procedurat për transportin e kamionit për zjarrfikës i dedikuar për NjPZSh në Lipjan. Obligimin kryesor në këtë drejtim e kishte marr për sipër AME/MPB të cilët ishin dakorduar që të paguaj shpenzimet e transportit në shumë prej 3000 eurosh ndërsa ne diku rreth 1000 euro sa do të kushtonin shpenzimet e rrugës dhe të akomodimit të stafit prej dy personave që do të vinin nga Finlanda (një nga donatori dhe një tjetër në cilësinë e trajnerit). Lidhur me çështjen e transportit donatori në Finlandë dhe ne këtu kemi kontaktuar shumë kompani që merren me këtë punë por edhe Klubi Rotarian nga Kosova. Ishte arritur pëlqimi trepalësh Donator- AME – Transportuaes dhe ishte definuar roli i Klubit Rotarian, dhe kur pritnim transferin e parave për transport,- nga AME pa asnjë paralajmërim njoftohemi se momentalisht nuk ka mjete për këtë projekt. Për situatën e krijuar në mënyrë të pashpjegueshme më së shumti nga neglizhenca e disa personave në AME , ne kemi njoftuar MPB dhe vetë ministrin i cili na ka pritur në takim ku i kemi shpjeguar tërë rrjedhën e deri atëherëshme të procesit. Me angazhimin e tij personal dhe të kabinetit të tij është arritur që MPB nga mjetet e tyre të siguroj mjetet e premtuara për të vazhduar me procedurat dhe për të mos e humbur donacionin i cili do të realizohet në janar 2018.

Edhe pse gjatë dhjetorit nuk janë shënuar reshje intensive, janë vërejtur vështirësitë e para të shkaktuara nga akumulimi i ujërave sipërfaqësore sidomos pranë rrugëve magjistrale e rajonale. Ne si edhe herëve tjera kemi përcjellë situatën në terren dhe për problemet e krijuara kemi njoftuar zyrën tuaj me Raporte të rregullta javore por edhe raporte të veçanta për këtë çështje. Në Raportet tona kemi përshkruar gjendjen, kemi evidentuar shkaktarët dhe kemi propozuar masat për tejkalimin e situatës.

Vlerësimi i gjendjes në terren sa i përket kërcënimit nga vërshimet po vazhdon edhe këto ditë dhe vlerësimi i përgjithshëm është se kërcënimi nga vërshimet në zonat e banuara ka shënuar

rënie si rezultat i pastrimit ,hapjes dhe zgjerimit të shtretërve të lumenjve dhe proçkave që është bërë vitin e kaluar dhe sivjet. Megjithatë nga pakujdesia e individëve (bizneseve) dhe neglizhenca e disa zyrtarëve komunal kërcënimi nga rrjedhja e ujit nëpër akse rrugore dhe pranë urës së Sitnicës është rritur.

Kërcënimet e evidentuara dhe të raportuara edhe më parë për rrezikun nga zjarri, në institucionet që administrohen përmes komunës (shkollat, QKMF dhe ambulancat në terren, objektet e zyrave të vendit , të kulturës e sportit) jo se janë zvogëluar por janë rritur edhe më shumë. Edhe në sektorin e biznesit privat kërcënimi nga zjarri po shënon rritje. Për ne ka mbetur i pakuptueshëm fakti se si ka mundur që në qytet të hapen tre nga supermarketet më të mëdha në qytet dhe asnjëra të mos ketë pranim teknik të objektit dhe rrjedhimisht as pajisje për mbrojtje nga zjarri . Ne gjatë dhjetorit me shkresa të veçanta u jemi drejtuar institucioneve përgjegjëse kemi reaguar edhe lidhur me disa parregullsi për shkak të parkimit të automjeteve të ndryshme pranë barrierave elektro mekanike në hyrje të sheshit “Adem Jashari “ por për çështjen askush nuk ka reaguar e madje as që kanë kthyer përgjigje për shqetësimin e ngritur.

Vështirësitë që përcjellin punën e NjPZSh të raportuara më parë kanë mbetur edhe më tutje prezentë andaj nuk e shohim të udhës ti përsërisim sepse tanimë janë të ditura për ju. Edhe në dhjetor në NjPZSh kanë qenë për vizitë nxënës dhe arsimtar nga shkollat fillore të cilët janë interesuar për punën e këtij shërbimi. Për ta janë mbajtur ligjërata dhe demonstrime praktike .

Lidhur me mundësinë e ligjëratave dhe trajnimeve për rrezikun nga zjarri dhe MKZ ne kemi ofruar gatishmërinë tonë që një gjë e këtillë të bëhet edhe në të ardhmen për kë do që është i interesuar.

Me respekt

Shtojcë : tabela e intervenimeve gjatë vitit 2017

Intervenimet e NjPZSh Lipjan , 2017

Lloji i Interven/ muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Gjithësejt			
1 Zjarre	16	14	24	12	9	9	36	87	63	14	8	7	299			
Shtëpi banimi	3	1	2				3	1	1	1	1					

Shtëpi ndihmëse			1	1			1	1	2	1						
Shtalla / Pleme *	1		1			3	3		3							
Locale		1	2									2				
Objekte afariste/ industriale*	3			1	2	1	1	1	2	1	2					
Male		2	13	5			3	18	11	1						
Ushqim bagëtish/grunajë*	3		1		1	1	2	5	7							
Bari i thatë/ sternishtë			1				18	52	30	2	1					
Goma / Mazut *		1					1									
Mbeturina – Kontejnerë	3	7	2	3	2/2	2	1	2	4	1	1	1				
Trafo /gjenerator *						1			1		2	1				
Orë rryme/ bomb.gazi*					1					2*						
Instalime të rrymës	1				1					1						
Shtylla	1		1	1				2	2	1	1					
Automjete/ kamion*	1	1	1*	1		1	1	3/1*		2/1		3				
Dru teknik/ thëngjill*								1								
2 Intervenime Teknike		7	7	2	4	3	6	7	4	1	4	3	6	54		
Aksidente komunikacioni	1			1	1	2	2	2	1	2	1	2				
Automjete																
Hapje dyeresh/ashensor*				1*	1	2	3					1				
Rrëtime																
Terhqje automjetesh	1															
Thithje e ujit/ thyrje akulli*		5														
Intervenime tjera teknike	5	2	2	2	1	2	2	2		2	2	3				
3 Shërbime			1	4	5	5	5	5	3	6	3	5	42			
Furnizime me ujë			1	2	2	3	4	3	2	3	1	1				
Pastrim rrugësh				2	2	2	1	2	1	2		3				
Sigurime											1	1				
prerje-largim drunjësh					1					1	1					
4 Shpëtime																
Shpëtime nga lartësia																
Shpëtime nga uji																
Shpëtime në hekurudha																
Vërshime																
Pjesëmarrje në xhirim filmi			1										1			
Ushtrim Aeroport /nxënës			1		2*							3*	7			
Alarme të rreme	1	1	2			1	1	3	2			1	12			
Zjarre	16	14	24	12	9	9	36	87	63	14	8	7	299			
Shërbime			1	4	5	5	5	5	3	6	3	5	42			
Shpëtime																
Intervenime Teknike	7	7	2	4	3	6	7	4	1	4	3	6	54			
Gjithsejt	24	22	31	20	19	21	49	99	69	24	14	22	414			